



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 31 tetor 2019.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të arsyetuar për kandidaturat e vakancave në Gjykatën Kushtetuese që i takojnë Kuvendit të Shqipërisë

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Damian Gjikhuri, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Andi Përmeti, Aurora Mara, Elda Hoti, Ediola Braha, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina dhe Artemis Dralo

Mungojnë:

Korab Lita, Jurgi Çyrbja, Alban Zeneli, Nikolin Staka dhe Tom Doshi

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Meqenëse kuorumi është i plotësuar, vazhdojmë me çështjen që kemi sot në rendin e ditës: miratimi i raportit të arsyetuar për kandidaturat e vakancave në Gjykatën Kushtetuese që i takojnë Kuvendit të Shqipërisë. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore do të jetë kolegja Klotilda Bushka.

Në fakt, për rëndësinë që ka miratimi i këtij raporti, e meriton këtë seancë të posaçme të Komisionit të Ligjeve. Në një mbledhje të mëparshme të Komisionit të Ligjeve zhvilluam seancën dëgjimore me kandidatët për anëtarë në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa sot, në zbatim të ligjit organik “Për Gjykatën Kushtetuese” dhe të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i Ligjeve do të diskutojë dhe do të miratojë raportin e arsyetuar me kandidaturat për vakancat në Gjykatën Kushtetuese për t’ia përcjellë më pas seancës plenare për votim për të vijuar me procedurat parlamentare, siç përcaktojnë neni 7/c i ligjit organik “Për Gjykatën Kushtetuese” dhe Rregullorja e Kuvendit.

E thënë më qartë, Kuvendi ka diskrecion të plotë që të votojë secilën nga kandidaturat me shumicë të cilësuar. Kandidati që merr 84 vota, quhet i zgjedhur si anëtar në Gjykatën Kushtetuese. Nëse Kuvendi nuk arrin të mbështesë njërin nga kandidatët në seancë plenare me votë, me shumicë të cilësuar, kandidati i renditur i pari nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi bëhet automatikisht anëtar i Gjykatës Kushtetuese. E njëjta situatë vlen edhe në rastin kur Kuvendi nuk arrin që brenda tridhjetë ditëve nga momenti i depozitimit të listës me kandidatët e renditur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, të ushtrojë të drejtën që i ka dhënë ligji, kandidati i renditur i pari, pas tridhjetë ditëve, bëhet automatikisht anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Gjithsesi, Kuvendi është brenda afatit të përcaktuar me ligj për të vijuar me procedurat parlamentare.

Pa humbur kohë, po ia kaloj fjalën koleges Klotilda Bushka për të bërë një paraqitje të raportit me gjetjet për secilën kandidate për anëtare, që ne i dëgjuam në seancën që kaloi.

Fjala është për zonjën Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Siç jeni në dijeni, sot do të shqyrtojmë raportet për miratimin e dy vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat duhet t’ia përcjellim seancës plenare. Të dyja vendet duhet t’i shqyrtojmë në komision, t’i sqarojmë të gjitha faktet, rrethanat dhe çështjet e plotësimit të

kritereve ligjore nga kandidatët nëpërmjet raportit që ne i paraqesim seancës plenare, sepse Kuvendi i Republikës është organ emërtese, sipas ligjit, për tri vende në Gjykatën Kushtetuese. Aktualisht, ne po shqyrtojmë plotësimin e dy vendeve vakante në kuadër të dy thirrjeve të shpallura nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në datën 12.02.2018 dhe në datën 04.03.2019.

Më lejoni fillimisht të sqaroj për të gjithë kolegët, por edhe për opinionin publik se puna që ne kryejmë sot, ky shqyrtim, pra miratimi i raportit përkatës për kandidatët për të dyja vendet vakante është një punë formale në kuadrin e shqyrtimit nga ana jonë të punës së kryer nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe të dërgimit të dokumentacionit përkatës, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ne nuk i hyjmë thelbit të vendimmarrjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili është organi i vetëm i ngarkuar nga ligji për sa i takon vlerësimin e kandidaturave, që kanë shprehur interesin për të qenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, pikëzimin e kandidaturave dhe në fund përcaktimin e renditjes së tyre sipas parashikimeve ligjore. Pra, në njëfarë mënyre, ne këtu shohim vetëm sa janë përmbushur procedurat përkatëse nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sa janë realizuar detyrimet ligjore dhe nuk i hyjmë thelbit të vendimmarrjes. Këtë dua ta theksoj pikërisht për të nënvizuar edhe një herë se reforma në drejtësi, duke pasur njërin prej qëllimeve të saj distancimin e vendimmarrjes politike në emërimet në sistemin e drejtësisë, dhe konkretisht në Gjykatën e Lartë, rolin e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtar në Gjykatën Kushtetuese ua dha vetëm organeve, të cilat krijohen me ligj dhe përbëhen nga përfaqësues të sistemit gjyqësor të organit të prokurorisë, dhe nuk ka vendimmarrje politike. Ndoshta për disa mund të mos jetë shumë e këndshme që unë ta them, por e vërteta është që, në bazë të parashikimeve ligjore, si Komisioni i Ligjeve, ashtu edhe seanca plenare e Kuvendit, në kuadër të shqyrtimit të kandidaturave, ka më shumë rolin e noterit, pasi nuk i hyn thelbit të vendimmarrjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dhe, sigurisht, seanca plenare, përveç kompetencave ligjore, ka edhe ushtrimin e vullnetit të secilit anëtar të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për vlerësimin me votë të secilit prej kandidatëve.

Pa humbur kohë, më duhet të them se nga shqyrtimi i të gjithë dokumentacionit që ka paraqitur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për të dyja grupet e kandidatëve, për të dyja vakancat e shpallura, dokumentacioni është i plotë, nuk ka asnjë mungesë, e cila mund ta detyronte Komisionin e Ligjeve ta kthente dosjen për plotësim në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Kjo është një nga kompetencat që mund të kemi ne për sa i takon natyrës negative të vendimmarrjes, çka do të thotë që këtë vendim mund ta kishim marrë vetëm nëse do të kishim

mungesë të dokumentacionit në dosjet e ardhura nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, gjë që nuk ka ndodhur, sepse Këshilli i Emërimeve në Drejtësi e ka paraqitur dosjen e plotë, ka përcaktuar të gjitha elementet, siç i ka detyrim ligjor në vendimmarrjen e tij, si dhe ka plotësuar të gjitha detyrat dhe kriteret që i ka ngarkuar ligji për të shqyrtuar, për të vlerësuar dhe për të vendosur.

Duke mos pasur asnjë mungesë në të dyja grupet e kandidatëve për sa i takon dokumentacionit nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke e vlerësuar edhe në seancën dëgjimore paraqitjen e kandidatëve seancën e kaluar, unë nuk do të doja të përsërisja se çfarë përfaqëson secili kandidat, pasi edhe në raportin që keni përpara për secilin kandidat ka një vlerësim, i cili vjen nga vendimet nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe për secilin kandidat keni një tabelë për pikët e marra në të gjitha aspektet profesionale, të integritetit dhe për kriteret e tjera, si të pasurisë e të tjera, të cilat janë pozitive, të vlerësuara me pikë, në bazë të të cilave është bërë edhe renditja e secilit kandidat për të dyja grupet e kandidimeve në vakancat e Gjykatës Kushtetuese.

Duke vlerësuar të gjitha këto që thashë, unë mendoj se ne duhet t'i miratojmë raportet që ju i keni përpara dhe që ju janë vënë në dispozicion, duke i propozuar seancës plenare, pra në bazë të këtyre raporteve, votimin e njërit prej kandidatëve në secilin grup për vakancat e Gjykatës Kushtetuese dhe, siç e parashtroi edhe kryetari Manja, në qoftë se nuk do të arrihet një shumicë e cilësuar (që e kërkon ligji) për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, i pari në listë do të jetë automatikisht anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Unë jam e hapur për pyetje. Nuk dua t'ju marr kohë dhe të flas për secilin kandidat, sepse, siç ju thashë, i keni të gjitha të listuara në tabelat përkatëse, por edhe vetë kandidatët në seancën e kaluar bënë një ekspozitë të asaj çfarë përfaqësojnë dhe të vizionit që kanë për të qenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Në fakt, siç edhe ju e theksuat, Komisioni i Ligjeve në rastin konkret është në rolin e një noteri, le të themi, publik, sepse organi i ngarkuar nga Kushtetuta për të bërë vlerësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore, si dhe pikëzimin e kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Nëse nga kolegët nuk ka pyetje, unë mendoj që t'i kalojmë sipas vendimeve përkatëse të ardhura nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Konkretisht, duke iu referuar kohës së shpalljes së vakancës për secilin nga grupet e kandidatëve, me vendimin nr. 130, datë

21.09.2019 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka miratuar listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese për vendin vakant (vakancë e plotë, e shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 12.02.2018) me renditjen si më poshtë: Arta Vorpsi, Elsa Toska dhe Besnik Muçi.

Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

E kam për relatoren. Në fakt, KED-ja mund të mos ketë bërë gabim, por unë dua të jem i qetë në ndërgjegjen time. Sipas ligjit nr. 8577 të vitit 2000, kandidati duhet të ketë 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, si avokat, si profesor, lektor dhe si nëpunës i nivelit të lartë të administratës. Më rezulton që nga të dyja kandidatet, njëra ka qenë specialiste e marrëdhënieve me jashtë në vitet '97-'98 në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa tjetra më rezulton që për disa muaj ka qenë ndihmëskomisionere pranë Avokatit të Popullit. Këto dy detyra, që kanë pasur në këto vite, a janë ekuivalente në sensin që quhen nëpunës të nivelit të lartë, që e plotësojnë kriterin e përvojës prej 15 vjetësh në sistemin e drejtësisë? Sepse të punosh ndihmëskomisionere ose specialist i marrëdhënieve me jashtë, le të themi, do të thotë se pak a shumë nuk kanë punuar direkt në fushën e jurisprudencës, si gjyqtarë, prokurorë, avokatë. Është ndryshe të jesh gjyqtar, prokuror, avokat dhe ndryshe të jesh një specialist në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë apo ndihmëskomisioner i Avokatit të Popullit për çështje të caktuara. Ndoshta e kam pyetje naive, por doja thjesht ta qartësoja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Ndërhyrja juaj është e drejtë, zoti Fino.

Pas seancës dëgjimore të herës së kaluar, edhe në varësi të pyetjeve që u kemi bërë kandidatëve, pikërisht për të vërtetuar pjesën e kohëzgjatjes që kërkon ligji si vjetërsi në punë për t'u konsideruar aplikanti si i mundshëm për të qenë i tillë në varësi të punës që ka kryer dhe të përvojës në ato institucione që kërkon ligji, është bërë verifikimi dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi e ka parë në mënyrë analitike edhe përvojën në punë, edhe arsyetimin pse kjo konsiderohet e tillë që i përmbush kriteret ligjore. Të njëjtën gjë kemi bërë edhe ne më pas me zyrën e këshilltarëve ligjorë, pra kemi verifikuar, dhe bëhet fjalë për punë në profesionin "jurist" në institucione kushtetuese, gjë që i përmbush kriteret për vjetërsinë në punë. Kështu që shqetësimi juaj është i drejtë, por e kemi verifikuar dhe jemi në përputhje me kriteret e ligjit.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Pra, duke qenë se të dy kanë qenë juristë në dy institucione kushtetuese, në Gjykatën Kushtetuese dhe tek Avokati i Popullit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, por edhe ne e kemi gjetur të bazuar në ligj si eksperiencë juristi në administratën e lartë shtetërore, pra e plotëson kriterin e vjetërsisë në punë.

Edhe një herë, meqenëse isha në fazën e hedhjes në votim, lidhur me vakancën e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 12.02.2018 (vakancë e plotë) me vendimin nr. 130, datë 21.09.2019, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka bërë listimin e kandidatëve si më poshtë: Arta Vorpsi, Elsa Toska dhe Besnik Muçi.

Raportit për kandidatin Besnik Muçi, që është tanimë anëtar i Gjykatës Kushtetuese, i dekretuar nga Presidenti i Republikës, të cilin ne do të votojmë tani dhe do t’ia dërgojmë seancës plenare, do t’i bashkëngjitet edhe dekreti i Presidentit.

Kush është dakord me raportin për vlerësimin e kandidaturave për anëtar të Gjykatës Kushtetuese (vakancë e plotë, e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 12.02.2018 me renditjen sipas vendimit nr. 130, datë 21.09.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi)?

Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një votë kundër e zotit Alimadhi. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet raporti për bllokun e parë të kandidaturave të listuara sipas vendimit nr. 130, datë 21.02.2019.

Kalojmë te miratimi i raportit për vlerësimin e kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese (vakancë e plotë, e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 04.03.2019). Edhe për këtë bllok kandidaturash, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me vendimin nr. 134, datë 21.09.2019 i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë tri kandidate sipas kësaj renditjeje: Arta Vorpsi, Fjona Papajorgji dhe Elsa Toska.

Kush është dakord me raportin për vlerësimin e kandidaturave? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet raporti për vlerësimin e kandidaturave për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, vakancë e plotë, e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 04.03.2019, sipas vendimit nr. 134, datë 21.09.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Me miratimin edhe të raportit të dytë për sa i përket bllokut të kandidatëve për vakancën e datës 04.03.2019, e mbyllim për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve. Raportet përkatëse, së bashku me dokumentacionin e kandidatëve, t’i përcillen seancës plenare për

votim, duke respektuar në mënyrë rigoroze afatin 30-ditor të përcaktuar nga ligji për votimin në Kuvendin e Shqipërisë të kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Shumë faleminderit kolegëve, si dhe medieve për pasqyrimin korrekt dhe transparent të kësaj seance të Komisionit të Ligjeve, e cila ka rëndësinë e saj për vetë faktin se Gjykata Kushtetuese është një nga institucionet që do të duhet të rifillojë nga puna së shpejti, duke pasur në konsideratë edhe numrin e çështjeve që presin të gjykohen në Gjykatën Kushtetuese, ku disa prej tyre kanë një ndjeshmëri të lartë si për opinionin publik, ashtu edhe për debatin politik në Shqipëri!

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA